



Organizuar nga  
Kosova Trail Running Association  
për të shënuar 20 vjetorin e fillimit të luftës  
dhe 10 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës

Organized by  
Kosova Trail Running Association  
to mark the 20<sup>th</sup> anniversary of Kosovo's war  
and 10<sup>th</sup> anniversary of independence



# Shtegu i Shpresës Trail of Hope



#trailofhope100  
3-4.03.2018

**“Shtegu i shpresës – Trail of Hope”**  
100km D+ 2000m (Prekaz – Glllogjan – Koshare)

# RREGULLORE

PËR PJESËMARRJE NË VRAPIMIN E SHTEGUT TË SHPRESËS

A: Rr. Fehmi Agani Nr. 25/8; 10000, Prishtina, Republic of Kosovo  
T: +377 45 280980; +377 44 965558 | E: [kosova.trailrunners@gmail.com](mailto:kosova.trailrunners@gmail.com) | [www.facebook.com/teamKTRA](http://www.facebook.com/teamKTRA)





## PËRMBAJTJA

1.	ORGANIZIMI .....	3
2.	INFORMATA TË PËRGJITHSHME .....	3
3.	INFORMACION PËR PJESËMARRËSIT .....	4
4.	DEKLARATA E PËRGJEGJËSISË .....	5
5.	PAVARËSIA GJATË VRAPIMIT .....	5
6.	SIGURIA DHE NDIHMA MJEKËSORE .....	5
7.	ZBATIMI.....	6
8.	PAJISJET OBLIGUESE DHE TË REKOMANDUARA.....	7
9.	ÇANTA ME RROBA TE THATA - DROP BAG .....	7
10.	STACIONET E KONTROLLIT DHE FURNIZIMIT .....	7
11.	AFATET KOHORE .....	8
12.	SHENJËZIMET NE SHTEG .....	9
13.	FOTOGRAFITË GJATË NGJARJES .....	9
14.	PËRGJEGJËSIA MJEDISORE.....	10
15.	PËRJASHTIMI .....	10
16.	TË DREJTAT E ORGANIZATORIT .....	10



## 1. ORGANIZIMI

Ngjarja “Shtegu i Shpresës” në distancë ultra-maratonike, organizohet nga klubi sportiv “Kosova Trail Running Asociation (KTRA)“.

KTRA qysh nga themelimi është anëtare e ITRA- International Trail Running Association. Ky event është i mbështetur nga Institucionet e Republikës së Kosovës si dhe institucionet e sigurisë, komuniteti i biznesit, sport-dashësit dhe organizatave të ndryshme që veprojnë në vend.

Sponsorizimin e ngjarjes përveç akteve zyrtar do e mbështesin edhe kompani të ndryshme vendore si dhe individ vullnetar.

## 2. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Për të shënuar 20 vjetorin e luftës për çlirimin e Kosovës dhe 10 vjetorin e shpalljes së pavarësisë, Asociacioni Kosovar për Vrapim Malor (Kosova Trail Running Association - KTRA) organizon me 3 dhe 4 mars vrapimin ultra-maratonik 100 kilometërsh përgjatë vatrave kryesore të rezistencës gjatë luftës në Kosovë.

Nën moton “Shtegu i Shpresës: I kujtojmë të gjithë,” KTRA synon të përkujtojë sakrificën e madhe të qytetarëve të Kosovës për lirinë e brezave të ardhshëm të saj dhe ndërtimin e shtetit të pavarur e të qëndrueshëm.

Shtegu i vrapimit, prej 100km që përfshinë ngjitje prej 2057 metra, fillon në Prekaz tek kompleksi përkujtimor “Adem Jashari” për të vazhduar në Likoshan, Glllogjan dhe me përfundim në Koshare në brezin kufitar me Republikën e Shqipërisë. Ky vrapim njëherit shënon aktivitetin e parë të këtij lloji të organizuar në Kosovë dhe synon që Kosovën ta vendosë në hartën turistike.

Kjo ngjarje nuk ka karakter garues kësaj radhe, organizatori parashef vrapim grupor dhe të asistuar përmes anëtarëve me përvojë në këtë shteg dhe në këto disciplina. Regjistrimi i pjesëmarrësve do kryhet online dhe fizikisht (në raste të veçanta) pa detyrim me pagesë.

Kjo ngjarje vrapimi në katër distanca do të zhvillohet përgjatë fshatrave:

**PREKAZ (starti 100km & 14km)** - Dashec - Baks - Çirez - Likoshan (**finish 14km**) - Shtuticë - Bajincë - Qabiq - Zabërgjë - Gllarevë - Dërsnik - Hotel Nora, Kline (**start 50km**) - Zajm - Grabanicë - Bokshiç - Glllogjan - Jabllanicë - Zhabel - Bardhaniq - Rakoc - Ratishë - **GLLOGJAN (start 21km)** - Irnznig - Prilep - Babolloq - Junik - Botushë - **KOSHARE (finish).**

Përgjatë këtij vrapimi malor dhe me terren të kombinuar do ipet mundësi të shifen dhe kalohet pranë shumë atraksione apo bukurive natyrore, buste, lapidar martirësh dhe viktimash, objekte të kultit fetar, ku disa nga objektet e kultit janë nën mbrojtje të trashëgimisë kulturore.

Ngjarja fillon me 03 Mars 2018 në ora 13:00, në Prekaz tek Kompleksi Memorial: Adem Jashari, ndërsa përfundon në Koshare rreth ores 10:00 – 12:00, me datë 04 Mars 2018.

Kjo ngjarje do zhvillohet në katër (4) kategori të gjatësisë:



- **Prekaz – Likoshan:** 14 kilometra, me 300metra ngjitje të fituara përgjatë stazës, fillim i vrapimit 03 Mars 2018 në kohën lokale 13:00, pjesëmarrësit në këtë distancë pritet të përfundojnë vrapimin brenda maksimum 3 orëve.
- **Klinë – Hotel Nora – Koshare:** 50 kilometra, me 1120metra ngjitje të fituara përgjatë stazës fillojnë 03 Mars 2018 në kohën lokale 23:00 – 24:00, pjesëmarrësit në këtë distancë pritet të përfundojnë vrapimin brenda maksimum 11 orëve.
- **Glllogjan- Koshare:** 21 kilometra me 730metra ngjitje të fituara përgjatë stazës, fillojnë me 04 Mars 2018 rreth orës 05:00 të mëngjesit, pjesëmarrësit në këtë distancë pritet të përfundojnë vrapimin brenda maksimum 6 orëve.
- **Prekaz – Koshare:** 100 kilometra, me 2057metra ngjitje të fituara përgjatë stazës, fillim i vrapimit me datë: 03 Mars 2018 në ora 13:00, në këtë distancë pjesëmarrësit e 100km pritet të përfundojnë vrapimin brenda 22 orëve.

Në mënyrë që të mbahen të përditësuar me informacion për ngjarjen pjesëmarrësit duhet të informohen përmes emailit zyrtar të KTRA: [kosova.trailrunners@gmail.com](mailto:kosova.trailrunners@gmail.com), web: [www.ktra-ks.com](http://www.ktra-ks.com) apo facebook/instagram: @teamktra

Nga të gjithë pjesëmarrësit kërkohet respektim i kohës së nisjes si dhe të jenë në vendin e nisjes së paku 1 orë para nisjes. Për tu paraqitur për vrapimin malor dhe për tu paisur me numra të pjesëmarrjes:

- **Pjesëmarrësit për vrapimin malor 100km dhe 14km, duhet të lajmrohen tek pika informuese në Prekaz (kompleksi memorial: Adem Jashari) nga ora 11:00 me datë 3 Mars 2018.**
- **Pjesëmarrësit për vrapimin malor 50km, duhet të lajmrohen tek pika informuese në Hotel Nora, Klinë nga ora 22:00 me datë 3 Mars 2018.**
- **Pjesëmarrësit për vrapimin malor 21km, duhet të lajmrohen tek pika informuese në kompleksin memorial në Glllogjan, nga ora 04:00 me datë 4 Mars 2018.**

### 3. INFORMACION PËR PJESËMARRËSIT

- Pjesëmarrja është e hapur për meshkuj dhe femra mbi 18 vjeç;
- Pjesëmarrësit nën moshën 18 vjeç mund të marrin pjesë me leje me shkrim nga prindi në vrapimin malor 14km;
- Pjesëmarrja në vrapimin malor është në përgjegjësi personale dhe organizatori nuk merr asnjë përgjegjësi në rast të lëndimit, aksidentit ose vdekjes;
- Çdo pjesëmarrës mbanë përgjegjësi personale për veprimet e tyre në dhe përreth shtegut, veçanërisht në rast të shkeljes së ligjeve të Republikës së Kosovës.
- Pjesëmarrësit duhet të jenë plotësisht të vetëdijshëm për gjatësinë dhe specifikimin e vrapimit malor dhe të jenë krejtësisht të gatshëm për atë;
- Pjesëmarrësit duhet kenë fituar përgaditje të duhur fizike dhe psikike si dhe aftësi për mbijetesë në kushtet malore, që kanë të bëjnë me ndryshimet në mikroklimë (shi, mjegull, era, dëborë, natë, temperaturë të ulët);
- Të jenë në gjendje të përballojnë izolimin, problemet fizike dhe mendore, problemet e tretjes,



dhimbjet në sistemin lokomotor;

- Të jenë plotësisht të vetëdijshëm se nuk është detyrë e organizatorit të ndihmojë në trajtimin e çështjeve dhe shqetësimeve të cekura më parë sidoqoftë organizatori parasheh të ofroj ndihmë të parë në raste të veçanta shëndetësore ;
- Duke bërë regjistrimin në njërën nga këto kategori vrapimi, çdo pjesëmarrës në formë elektronike të regjistrimit online konfirmon se është në dijeni të rreziqeve të konkurrencës në natyrë dhe merr rrezikun për veten e tyre ku po ashtu secili pjesëmarrës duhet cek dhe merr parasysh problemet e tij shëndetësore.
- KTRA si organizator do kujdeset që në bashkëpunim me komunat apo regionet përkatëse të ofroj gjithë përkrahjen në aspekt të sigurisë si dhe shërbimet statike apo në lëvizje ambulatore apo shëndetësore në raste të komplikimeve serioze që vijnë si pasojë e humbjes së shtegut , sigurisë në komunikacion, lëndimit ose sëmundjes.
- KTRA do të ofroj ushqim dhe pije freskues ne 9 pika stacionare gjatë tërë gjatësisë 100 K edhe pse ne si organizues ju sugjerojmë të keni ushqimet apo suplementet e juaja personale gjatë tërë kohës.

#### 4. DEKLARATA E PËRGJEGJËSISË

Regjistrimi vullnetar dhe pastaj pjesëmarrja në ngjarjen “Shtigjet e Shpresës” determinon ose përcakton se pjesëmarrësi është i njohur me këto rregulla si dhe pajtohet të pranojë plotësisht principet dhe rregulloret e përcaktuara këtu.

#### 5. PAVARËSIA GJATË VRAPIMIT

Termi "i pavarur" nënkupton aftësinë e një pjesëmarrësi të varet nga vetëvetja në pothuajse çdo pjesë të vrapimit malor. Përveç ushqimit dhe pijeve personale, kjo vlenë edhe për veshjet dhe pajisjet gjatë ngjarjes, duke i bërë pjesëmarrësit të aftë të përshtaten me mjedisin (stuhi, lëndimet).

Në pikat e kontrollit apo pushimit pjesëmarrësi mund të marrë ushqime të shpejta dhe ujë nga organizatorët e vrapimit malor, por midis këtyre pikave, pjesëmarrësi duhet të jetë në gjendje të mbështetet në pajisjet, ushqimin dhe pijet, gatishmërinë dhe elasticitetin e tij/sajë.

Pjesëmarrësit duhet të kenë përvojën për t'iu përshtatur kushteve të natyrës, ndryshimeve të pa pritura në kushtet e motit, shiut, stuhive, takimeve me kafshët.

Organizatori do të shënjoj rrugën në mënyrë të përshtatshme detajet në seksionin (shënjëzimi i shtegut); megjithatë, pjesëmarrësit duhet të kenë një sens minimal të orientimit në natyrë.

#### 6. SIGURIA DHE NDIHMA MJEKËSORE

Ekipet e asistencës mjekësore (Komunat/FSK/KFOR etj) do të sigurohen përgjatë rrugës në rast emergjence. Në rast të lëndimit ose ndonjë nevojë tjetër, pjesëmarrësit do të duhet të thërrasin telefonin SOS të ofruar nga organizatori.

Nëse ata janë në zonën e cila nuk mbulohet nga sinjali telefonik, ata do të duhet të përcjellin mesazhin në pikën e parë të ardhshme të kontrollit - në mënyrë që veprimet të ndërmerren sa më shpejt që të jetë e mundur.



Në secilën pikë kontrolli/rikuperimi organizatori do të vendos pajisjet themelore emergjente (fashë, fllaster, Jod-Betadine, barna bazë); këto do të jenë në dispozicion për vrapues nga vullnetarët.

Sugjerojmë që secili pjesëmarrës të ketë një pako individuale mjekësore në çantën tij/saj: (paracetamol, fasha apo shtrëngues, jod, mbulojë izoluese termorregulluese)

Organizatori do të bëjë çmos për të zvogëluar rreziqet, sidoqoftë, me mirësi pyesim pjesëmarrësit të ndjekin këshillat dhe rekomandimet tona.

- Ne këshillojmë që çdo pjesëmarrës/vrapues të ketë një sigurim shëndetësor.
- Ne këshillojmë rregullisht të gjithë pjesëmarrësit për të monitoruar gjendjen e tyre shëndetësore dhe gjithashtu, rekomandojmë një test stresi një para ngjarjes për të përcaktuar nivelin e fitnesit/ qëndrueshmërisë për këtë lloj sporti.

Për të ruajtur sigurinë dhe shëndetin e pjesëmarrësve, ekipet mjekësore kontrolluese kanë fuqinë për të ndaluar dhe larguar nje pjesëmarrës nga ngjarja nëse ata vlerësohen se nuk janë më në gjendje të vazhdojnë me tutje shkak i komplikimeve shëndetsore apo rrezikimit të shëndetit të tyre.

Nëse një pjesëmarrës i till nuk perfillë udhëzimet e tilla atëherë përgjegjësia mbetet mbi të njejtin sikurse pjesëmarrja në këtë event.

Sidoqoftë, pjesëmarrësve do tu kërkohet të ndjekin udhëzimet nga koordinatori/asistentet apo vullnetarët e ngjarjes dhe ekipet mjekësore gjatë rrugës. Këta individë perkahës do të kenë shenja identifikuese.

Çdo shkelje e këtyre udhëzimeve do të çojë në skualifikimin e një pjesëmarrësi mirëpo siç u cek më lartë nëse ai/ajo vendos të vazhdojë me çdo kusht, organizatori nuk merr përgjegjësi për efektet anësore të mundshme.

Çdo pjesëmarrës që ka ndonjë sëmundje ose gjendje mjekësore këshillohet që të konsultohet me një specialist për leje për të marrë pjesë në kesi llojë eventesh.

## 7. ZBATIMI

Regjistrimi fillon më 20 Janar 2018 dhe zgjat deri më 20 Shkurt 2018.

Nëse vrapimi malor anulohet ose ndërpritet për shkak të faktorëve atmosferikë ose ndonjë faktori jashtë kontrollit të organizatorit (vis major), pjesëmarrësi është i obliguar të ecë dhe pres për ndihmë, orientim apo transport sipas udhëzimit të kontaktit emergjent që ka të shënuar në telefon dhe në fletën me numër të ngjarjes. Duhet kihet parasysh se prioritet në transport do kenë rastet me emergjente (të lënduar apo te humbur).

Anulimi për shkak të lëndimit. Në rastin e dëmtimeve jo kronike osteo-artikulare ose muskulare të fituara pas regjistrimit dhe jo plotësisht të shërueshme para fillimit ne rekomandojmë anulimin e pjesëmarrjes në ngjarjen në fjalë.



## 8. PAJISJET OBLIGUESE DHE TË REKOMANDUARA

1. **Numri i pjesëmarrësit:** i bashkangjitur në pjesën e përparme të trupit - qartë e dukshme- OBLIGATIVE
2. **Telefoni celular:** të ndezur tërë kohën- OBLIGATIVE
3. **Paketa e ndihmës së parë:** OBLIGATIVE për pjesëmarrësit në 100km dhe 50km
4. **Llamba e kokës:** me bateri shtesë- OBLIGATIVE për pjesëmarrësit në 100km dhe 50km
5. **Xhakëtë shiu:** i përshtatshëm për kushtet në mal
6. **Ujë:** në shishe në një çantë të përshtatshme shpine – minimum 1 liter-REKOMANDUAR
7. **Mbulesa mbijetese:** OBLIGATIVE për pjesëmarrësit në 100km dhe 50km
8. **Filikaq:** OBLIGATIVE për pjesëmarrësit në 100km dhe 50km
9. **Jakne e lehtë sportive:** REKOMANDUAR
10. **Bluzë me mëngë të gjata:** REKOMANDUAR
11. **Fanela rezervë:** REKOMANDUAR
12. **Kapelë, maskë, shallë:** REKOMANDUAR
13. **Dorëza:** REKOMANDUAR
14. **Çokollada energjike ose ushqime të ngurta të ngjajshme -** REKOMANDUAR

Pjesëmarrësit duhet të mbajnë pajisjet OBLIGATIVE me vete gjatë gjithë vrapimit malor. Organizatori ka të drejtë të verifikojë pajisjen e detyrueshme të pjesëmarrësve në çdo pikë kontrolli (edhe pa paralajmërim) dhe në rast të mungesës do të evidentohet si vërejtje e dhënë.

Pajisjet e deklaruara si të REKOMANDUARA nga organizatori nuk janë të detyrueshme për ti poseduar gjatë ngjarjes, por rekomandohet që të zotërohen nga vrapuesit.

Përdorimi i shkopinjve të ecjes (hikingut) lejohet nëse pjesëmarrësi vendos të përdorë, ai / ajo duhet t'i ketë ato gjatë gjithë vrapit.

## 9. ÇANTA ME RROBA TE THATA - DROP BAG

në distancat 100Km, 50Km dhe 21Km që dëshirojnë çantë shtesë, të njëjtit do të pajisen me një qese të zeze dhe numër BiB (nga organizatori) i cili së bashku me artikujt më të nevojshëm të pjesëmarrësve mund të lihen në selinë e organizatorit para fillimit. Çanta me rroba të thata do të jetë në dispozicion në stacionin apo distancat 50km tek Hotel Nora, Klinë, 80km në Glllogjan, 100Km në përfundim në Koshare, por dhe në stacione tjera nëse organizatori ka mundësi teknike për këtë.

Në fund të ngjarjes, pjesëmarrësit mund të marrin çantat/qeset e tyre nga organizuesit e vrapimit pasi të tregojnë numrin e tyre të BIB.

Nëse nuk paraqiten për të marrë çantën brenda 12 orëve pas vrapimit, ajo çantë/qese ka gjasa ti nënshtrohet shkatërrimit për shkak të arsyeve higjienike.

## 10. STACIONET E KONTROLLIT DHE FURNIZIMIT

Janë gjithsejt 9 stacione apo pika të kontrollit dhe ndihmës për vrapuesit përafërsisht në çdo 10km te shtegut 100km.



Në këto pika pjesëmarrësit do të skanohen (regjistrohen), si dhe do të marrin ndihmën përkatëse shëndetësore, ushqim (pemë, ëmbëlsira, kripë etj.), ujë dhe pije të tjera për freskim.

Kontrolli në secilën nga pikat e vrapimit malor është i detyrueshëm. Kushdo që nuk shfaqet në asnjë nga pikat e kontrollit do të njifet i kualifikuar nga ngjarja zyrtare. Vetëm pjesëmarrësit me numër janë të lejuar të shërbehen në këto pika stacionare:

STACIONI	SHËRBIMET	DISTANCA TOTALE (KM)	DISTANCA DERI NE STACIONIN TJETËR (KM)	NGJITJE TOTALE (METRA)	NGJITJE DERI NE STACIONIN TJETËR (METRA)	KOHA E PËRAFËRT E ARRITJES NË STACIONE
Prekaz <b>START</b> 100km & 14km 42.753595, 20.805479		0	10	0	226	13:00 (03 Mars 2018)
Baks 42.717330, 20.871371		10	4.9	226	73	14:40
Likoshan <b>Finish 14km</b> 42.698729, 20.892219		14.9	8.2	299	118	16:00
Terstenik 42.665239, 20.838599		23.1	5.1	417	189	17:10
Abri e Epërme 42.637797, 20.791553		28.4	12.2	606	158	18:40
Gllarevë 42.589495, 20.679421		40.5	12.5	764	83	22:20
Hotel Nora – Klinë <b>Start 50km</b> 42.592730, 20.567996		53.1	8.1	847	164	23:40
Glllogjan i Klinës 42.565555, 20.491241		61.3	16.7	1011	268	02:00 (04 Mars 2018)
Glllogjan <b>Start 21km</b> 42.509483, 20.363052		78	11.4	1279	152	05:30
Junik 42.476048, 20.277122		89.5	6.1	1431	276	07:30
Hotel Koshare – Batushë 42.457972, 20.243847		95.7	4.2	1707	350	09:00
Koshare <b>FINISH</b> 100km, 50km & 21km 42.454849, 20.212276		100	0	2057	0	11:00

## 11. AFATET KOHORE

**Vrapimi 14km**, afati kohor zyrtar për përfundimin e vrapimit malor është 2 orë pas fillimit (arritja në finish, ora lokale 14:00, datë 03 Mars 2018).





**Vrapimi 21km**, afati kohor për përfundimin e vrapimit malor është 6 orë pas fillimit (fillimi rreth orës 05:00 dhe arritja ne finish në ora 12:00 lokale, datë 04 Mars 2018).

**Vrapimi 50km**, Afati kohor për përfundimin e vrapimit malor është 12 orë pas fillimit (fillimi rreth ores 2400 dhe arritja ne finish në ora 12:00 kohë lokale, datë 04 Mars 2018)

**Vrapimi 100km**, afati kohorë i paraparë është 23 orë pas fillimit të vrapimit malor (fillimi në ora 13:00 dhe arritja ne finish rreth orës 12:00 kohë lokale, datë 04 Mars 2018).

Vetëm në pikat e kontrollit Hotel “Nora” dhe Gllogjan, transporti do të sigurohet në fund për ata vrapues që nuk janë në gjendje të vazhdojnë vrapimin ose nuk kanë arritur të përmbushin afatin kohor të caktuar nga organizatori.

## 12. SHENJËZIMET NE SHTEG

Shiritat e kuq e bardhë janë shenjat zyrtare për orientim apo shenjzim gjatë përshkimit te rrugës vrapuese dhe ata do të vendosen në distancën e duhur në mënyrë që pjesëmarrësit të mos kenë probleme të mëdha me orientim.

Këto shenja ka gjasa do përforcohen me shirita shtesë fluroshent që garantojnë pamje gjatë vrapimit të natës (afër 12 ore do vrapohet në errësirë).

Lejohet dhe rekomandohet përdorimi i navigacionit GPS dhe Google maps, që pjesëmarrësit do të kenë siguri shtesë në orientim.

Sidoqoftë, orientimi me GPS është orientim i përafërt për shkak të ndryshimeve në gjendjen në terren mund të bëhen rregullime të vogla në shtegë, sepse ngjarja konsiderohet zyrtarisht shenja - sinjalizimi me vija të kuqe dhe të bardha.

Nëse ndonjë nga pjesëmarrësit ndahet nga grupi, vazhdon dhe humbë shenjzimin është e këshillueshme që i njëjti të kthehet në pikën e fundit ku kishte një shenjë dhe nga ajo te kërkojë me kujdes shenjën në drejtim tjetër të duhur.

Duhet kihet parasysh se gjatë aktivitetit duhet futen gjithsesi në funksion edhe aftësitë mbijetuese dhe përgaditja e duhur psikologjike përveç asaj fizike sepse jo çdo gjë mundë të shkojë përkryer në një terren malor ku kushtet atmosferike, terreni mund të paraqesin vështirësi të caktuara gjatë një periudhe kohore.

Në këto liniqe mund të analizohet shtegu, si dhe të shkarkohen dokumentet e hartës për ti ngarkuar në telefon të mençur (përmes google maps) apo pajisje të specializuar:

**Shtegu (Trail):** <https://tracedetail.fr/en/trace/trace/51277>

**Google maps:** [https://www.google.com/maps/d/u/0/edit?mid=16a7-rTzkwf0EtB\\_N5\\_TIZG2Zjvo5Hjtn&ll=42.61252431740105%2C20.5505455&z=11](https://www.google.com/maps/d/u/0/edit?mid=16a7-rTzkwf0EtB_N5_TIZG2Zjvo5Hjtn&ll=42.61252431740105%2C20.5505455&z=11)

**KTRA web:** <http://www.ktra-ks.com/ngjarjet/>

## 13. FOTOGRAFITË GJATË NGJARJES

Duke pranuar këto rregulla, secili pjesëmarrës pranon që mund të perdoret emri, fotografia në të gjitha hapësirat mediale dhe rrjetet sociale qoftë nga organizatorët apo sponsorët e kësaj ngjarje për



qëllime promovuese, si dhe heq dorë nga kërkesa e tyre për të drejtën e autorit mbi fotografitë zyrtare të ngjarjes.

Andaj, të gjitha fotografitë zyrtare të ngjarjes janë pronë e organizatorit dhe ato mund të përdoren, shfrytëzohen dhe merren pa miratimin paraprak.

## 14. PËRGJEGJËSIA MJEDISORE

Vrapimi "Shtegu i Shpresës" do të jetë ngjarje që kërkon poashtu një sjellje të përgjegjshme për mjedisin. Ne si organizatorë ju bëjmë thirrje të gjithë pjesëmarrësve, vullnetarëve dhe publikut, që të jeni jashtëzakonisht të kujdesshëm dhe të mos ndotni mjedisin përmes hedhjes apo lënies së mbeturinave apo rrobave në vende jo përkatëse.

Pjesëmarrësit të cilët kanë nevojë për hedhje mbeturinash duhet ti sjellin mbeturinat dhe ti lënë ato në pikën e ardhshme të kontrollit apo ti lënë ato në çantat personale deri sa ta gjejnë një pikë adekuate për ti hedhur.

Le të përpiqemi që sjellja jonë të jetë një shembull për të tjerët dhe të kontribuojë që natyra dhe mjedisi të mbeten të pastërta dhe të pandotura - për ne dhe për brezat e ardhshme.

## 15. PËRJASHTIMI

Organizatori ka të drejtë të konsiderojë të skualifikuar një pjesëmarrës në situatat e mëposhtme:

- Vrapuesi NUK është i regjistruar në një pikë kontrolli.
- Bën me qëllim shkurtime të rrugës gjatë shtegut.
- Nuk ndihmon një vrapues që ka nevojë për ndihmë.
- Përdorur një mjet transportit gjatë shtegut, pa qenë i detyruar për shkaqe shëndetësore.
- Kundërshton kontrollet nga organizatorët gjatë vrapimit.
- Nuk posedojnë pajisje të detyrueshme ose refuzojnë ta tregojnë atë në një inspektim të mundshëm nga vullnetarët.
- E shkel një urdhër të një personi kompetent - organizator, apo personel ndihmës mjekësore,
- Bën ndryshime në rrugë apo shenjëzim duke devijuar edhe tjetrin apo grupin.

## 16. TË DREJTAT E ORGANIZATORIT

Organizatori rezervon të drejtën për të modifikuar dhe ndryshuar rrugën e vrapimit malor, pikat e kontrollit dhe kohën e fillimit në çdo kohë për shkak të arsyeve objektive.

Nëse ndonjë mot i padëshirueshëm (mundësia e stuhisë apo përkeqësimi i kohës), organizatori rezervon të drejtën për të bërë ndryshime në çdo pjesë të rrugës ose të anulojë ngjarjan.

Fillimi i vrapimit mund të ndryshoj për disa orë apo mund të zhvendoset për shkak të kushteve të padëshirueshme klimatike.

**KTRA, Prishtinë, 20 Janar 2018**



## KUSH JEMI NE

**KOSOVA TRAIL RUNNING ASSOCIATION është organizatë e pavarur sportive jofitimprurës, me qëllim të:**

- promovimit dhe masivizimit të vrapimit malor (trail and ultra trail-running);
- shënimit të shtigjeve për vrapim malor dhe organizimi i garave kombëtare dhe ndërkombëtare të vrapimit malor;
- përkrahjes dhe fuqizimit të klubeve sportive dhe apo organizatave me qëllime të ngjashme;
- promovimit, masivizimit të ushtrimeve trupore të llojit 'Cross Fit' dhe pjesëmarrja në gara të tyre;
- pjesëmarrjes në gara (apo organizimi i garave) të disiplinave të ndryshme, si të: maratonave, triatlonave, maratonave të notit, çiklizëm, skijim, etj; si dhe
- promovimit dhe pjesëmarrjes në ngjitje alpine, bjeshkatari dhe ecje malore.

### **Aktivitetet e deritanishme në të anëtarëve të KTRA:**

- Në vitin 2014, pjesëmarrje në maratonën prej 42.195 KM në Budapest, Hungari;
- Në vitin 2015 në maratonën prej 42.195 KM në Stamboll, Turqi;
- Në vitin 2016 shënimi i shtegut të maratonës kombëtare të Malësisë së Gjakovës, Gjakovë – Bajram Curr
- Në vitin 2016, pjesëmarrje në njërën prej maratonave interesante evropiane, asaj të 33 më radhë të maratonës së Vjenës.
- Në vitin 2017, pjesë u shënuan disa aktivitete si pjesëmarrje në:
  - Maratonën e Parisit,
  - Ultra-Trailin e Qipros,
  - Ultra-Trailin e Krali Marko, Maqedoni;
  - Gjysmë-maratonën e Tiranës,
  - Maratonën e Frenzes dhe
  - Maratonën Ulqin – Shkodër me rastin e festës së Flamurit.
- Po ashtu, në vitin 2017, me sukses pushtuam Everestin, Eiger, Ama Dablam dhe Jezercën.

### **KOSOVA TRAIL RUNNING ASSOCIATION**

**Adresa:** Rr. Fehmi Agani Nr. 25/8; 10000, Prishtina, Republic of Kosovo

**Tel:** +377 45 280980; +377 44 965558

**E-mail:** kosova.trailrunners@gmail.com

**Web:** www.ktra-ks.com

**Facebook:** www.facebook.com/teamKTRA

**Xhirollogaria:** 1501110004110641, Raiffeisen Bank Kosovo

**Nr. i regjistrimit:** 5116904-2

**Nr. fiskal:** 601870795